



BIENVENUE
WILLKOMMEN
BENVENUTI
WELCOME
BEM-VINDO
BIENVENIDA
MIRË SE VJEN
DOBRODOŠLI
HOŞGELDİNİZ
KU SOO DHOWOW
BUN VENIT
SZERENCSESEN ERKESZTEK
VÍTEJTE
أهلا وسهلا

NEUCHÂTEL

BEVAIX - BOUDRY - BROT-DESSOUS - BROT-PLAMBOZ - CORCELLES-CORMONDRÈCHE - CORNAUX - CORTAILLOD - CRESSIER - ENGES
FRESENS - GORGIER - HAUTERIVE - LA BRÉVINE - LA CHAUX-DE-FONDS - LA CHAUX-DU-MILIEU - LA CÔTE-AUX-FÉES - LA SAGNE - LA TÈNE
LE CÉRNEUX-PEQUIGNOT - LE LANDERON - LE LOCLE - LES BRENETS - LES PLANCHETTES - LES PONTS-DE-MARTEL - LES VERRIÈRES
LIGNIÈRES - MILVIGNES - MONTALCHEZ - NEUCHÂTEL - PESEUX - ROCHEFORT - SAINT-AUBIN-SAUGES - SAINT-BLAISE - VALANGIN
VAL-DE-RUZ - VAL-DE-TRAVERS - VAUMARCUS

NEUCHATEL

ALBANAIS | 2015

Mirë se vini në kantonin e Neuchâtel-it

*Mirë se vini
në kantonin e Neuchâtel-it*

BIENVENUE
WILLKOMMEN
BENVENUTI
WELCOME
BEM-VINDO
BIENVENIDA
MIRË SE VJEN
DOBRODOŠLI
HOŞGELDİNİZ
KU SOO DHOWOW
BUN VENIT
SZERENCSESEN ERKESZTEK
VÍTEJTE
أهلا وسهلا

NEUCHÂTEL



Pasqyra e lëndës

FAQET

Mirë se vini në kantonin e Neuchâtel-it	1
Harta e kantonit të Neuchâtel-it	2-3
Informacione të përgjithshme	4
# Kantoni i Neuchâtelit është...	4
# Nëqoftëse keni nevojë për ndihmë dhe për informata	4
Kontakte informative	5-6
# Shërbimi i kohezionit multikulturor	5
# Site interneti të nevojshme	5
# Numra urgjence	6
# Konsultime juridike	6
# Sportel informacioni "Europe"	6
Sa për dijeni	7-10
# E drejta e votës për të huajt dhe të huajat	7
# Natyralizimi ose marrja e nënshtetësisë	7
# Lejet e qëndrimit	8
# Shkollat	8
# Plani i karrierës	9
# Studime dhe formacion profesional	9
# Formimi i të rriturve	10
# Kurse frëngjishteje	10

Mirë se vini në kantonin e Neuchâtel-it

Nëse vini nga një krahinë tjetër e Zvicrës, nga një vënd fqinjë apo nga një horizont akoma më i largët, ne kemi kënaqësinë t'ju mirëpresim.

Neuchâтели ju ofron një kuadër jete me nivel të lartë me liqenin dhe me lartësitë e luginave, me peisazhet e mrekullueshme dhe me natyrën e tij kaq të ruajtur. Në sajë të teknologjisë së përparuar të degëve të industrisë si dhe kompetencave profesionale të punonjësve të saj, ai ka krijuar një famë të lakmueshme. Kudo në botë, një prodhim i Neuchâtelit është sinonimi i cilësisë.

Kantoni i Neuchâtelit kultivon shpirtin e tolerancës dhe të hapjes. Shumëllojshmëria e origjinave, besimeve dhe kulturave është një burim pasurie për kantonin dhe për popullsinë e tij.

Nëpërmjet kësaj broshure, ne ju urojmë mirëseardhjen si dhe ju propozojmë disa adresa dhe informacione që mund t'ju shërbejnë.


Duke ju konsideruar si fqinjët e sotëm, shpresojmë që në të ardhmen ju të bëheni miqtë dhe mikeshat tona.

Qeveria e Republikës dhe Kantonit të Neuchâtelit.
(Gouvernement de la République et canton de Neuchâtel)
Grupi i punës për integrimin dhe kohezion multikulturor
(Communauté pour l'intégration et la cohésion multiculturelle)



Harta e kantonit të Neuchâtel-it

2



3



Informacione të përgjithshme

KANTONI I NEUCHATELIT ËSHTË...

- Një sipërfaqe prej 803 km².
- Një tërësi popullore prej rreth 175'000 banorësh, që përmban në rradhët e saj një popullsi të huaj të regjistruar prej rreth 45'000 vetash (~25%), e ardhur nga më shumë se 153 vende të botës.
- 37 komuna të ndara në gjashtë rajone.
- Një prej 26 kantoneve dhe gjysmë-kantoneve që përbëjnë Zvicrën. Një kanton ku flitet frëngjishtja.
- E mbi të gjitha, një kanton me traditë mikpritjeje, historia ekonomike, sociale dhe kulturore e të cilit, shpesh është dalluar nga dyndjet e njëpasnjëshme.

NËQOFTËSE KENI NEVOJË PËR NDIHMË DHE PËR INFORMATA

- Adresohuni fillimisht në komunën tuaj të banimit, është e këshillueshme të paraqiteni personalisht në administratën komunale.
- Po ashtu, është e mundur të kontaktohet shërbimi telefonik i informimit social, për këshilla dhe orientim:
nga e hëna deri të premten prej orës 14 deri në 17
në numrin e telefonit 0800 123 456 (numër gratis).

Kontakte informative

SHËRBIMI I KOHEZIONIT MULTIKULTOROR (SERVICE DE LA COHÉSION MULTICULTURELLE)

Shërbimi i kohezionit multikultoror është një shërbim kantonial, mandati kryesor i të cilit është favorizimi i kontakteve dhe i mirëkuptimit midis popullsisë autoktone dhe asaj të shpërngulur. Ky shërbim është po aq aktiv edhe për parandalimin e racizmit. Ai këshillon dhe mbështet projektet e shoqatave që kanë si pikësynim integrimin e të huajve dhe të huajve. Ai mundëson veçanërisht shërbimet e mëposhtme:

- një qëndër kontakti dhe informimi në gjuhë të ndryshme, e hapur për të gjithë, ku njerëz të përgatitur ju këshillojnë me kompetenca mbi fushat kryesore të jetës, duke ju garantuar gjithashtu sekretin profesional.
- një listë me mundësitë e mësimin të gjuhës frënge.
- një listë me kurset e gjuhës dhe të kulturës së vendeve të ndryshme.
- një listë adresash të komuniteteve të huaja në kanton.
- një listë përkthyesish dhe përkthyesesh, ashtu si dhe ndërmjetësish dhe ndërmjetësesh socio-kulturore - e.

Për të gjitha informatat ose pyetjet:

**Shërbimi i kohezionit multikultoror
(Service de la cohésion multiculturelle)**
Avenue Léopold-Robert 90
2300 La Chaux-de-Fonds
Rue des Beaux-Arts 13
2000 Neuchâtel

www.ne.ch/cosm

032 889 74 42

032 889 48 50

SITE INTERNETI TË NEVOJSHME

- Siti i Shtetit të Neuchâtelit propozon informata të nevojshme, ashtu si dhe lidhje me qytetet, komunat dhe Konfederatën: www.ne.ch
- Faqet www.ne.ch/migrationsetintegration ju informojnë më imtësisht mbi problemet e emigracionit, integrimin dhe natyralizimit.
- Siti i Sekretariatit të Shtetit për emigrimin (SEM) www.sem.admin.ch do t'ju japë informata mbi çështjet e emigracionit, integrimin dhe natyralizimit në nivel federal.

Kontakte informative

NUMRA URGJENCE

Policia (Police)	117
Zjarrfikësit (Feu)	118
Ndihma e shpejtë rrugore (Secours routier)	140
Përkrahja në rast nevoje (La main tendue)	143
Ambulanca (Ambulances)	144
Helmimet (Intoxications)	145

KONSULTIME JURIDIKE

Rue des Beaux-Arts 11, kati i 1-rë (të mërkurën nga ora 16.00 deri më 19.00)
2000 **Neuchâtel**

www.oan.ch

Rue du Parc 65, kati i parë (të enjten, nga ora 16.00 deri 19.00)
2300 **La Chaux-de-Fonds**

www.oan.ch

Konsultimi me avokatin është falas. Megjithatë, një shumë prej 30 frangash duhet të paguhet, për të mbuluar shpenzimet administrative. Regjistrimi bëhet kur paraqitesh, për të marrë takim në të njëjtën ditë.

SPORTELE INFORMACIONI "EUROPE"

Ky sportel ju informon mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me qarkullimin e lirë të njerëzve, pasurive dhe shërbimeve në Europë:

Dogana e Col-des-Roches
25130 **Villers-le-Lac (France)**

Tél: 0033 3 81 68 12 13 / Fax: 0033 3 81 68 16 64

www.douane.gouv.fr

Sa për dijeni

E DREJTA E VOTËS PËR TË HUAJT DHE TË HUAJAT

Të vendosesh në kantonin e Neuchâtel-it, do të thotë të hysh konkretisht në jetën e shoqërisë me anë të pjesëmarrjes në jetën politike ose edhe më tepër, duke manifestuar përkatësinë tënde të plotë me anë marrjes së kombësisë zvicerane.

Sot, të huajt që janë të paisur me një leje vendosjeje të përhershme (permis C) dhe që kanë mbushur moshën 18 vjeçare mundën:

- të votojnë dhe të zgjidhen në rang komunal, përafërsisht pas një viti qëndrimi në kanton.
- të votojnë në rang kantonial pas përafërsisht 5 vjet qëndrimi në kanton.

Për të gjitha informatat, mund të adresoheni në komunën tuaj të banimit.

NATYRALIZIMI OSE MARRJA E NËNSHTETËSISË

Nënshtetësia Zvicerane fitohet nga trashëgimia prindërore, adaptimi ose natyralizimi. Ajo është një etapë e rëndësishme për tu integruar plotësisht në jetën e vëndit. Ligji parashikon dy procedura:

- Natyralizimi i thjeshtëzuar, që iu adresohet atyre, të cilët kanë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë familiare me një person të kombësisë zvicerane. Afati për të dorëzuar aplikimin ndryshon në varësi të rastit në fjalë.
- Natyralizimi i zakonshëm është procedura që duhet të ndjekin të gjithë ata persona që nuk kanë asnjë lidhje familjare direkte me një shtetas ose një shtetase zvicerane, ashtu si edhe ata persona, të cilët janë të lidhur nëpërmjet partneritetit të regjistruar me një shtetas apo një shtetase zvicerane. Një kërkesë mund të paraqitet, - (vetëm në raste të veçanta) pas dymbëdhjetë vjetësh qëndrimi në Zvicër, tre prej të cilëve në kanton. Për të rinjtë, vitet e kaluara në Zvicër, midis moshës 10 e 20 vjeç, numërohen dyfish.

Ligji vendos akoma kritere të tjera dhe parashikon shumë raste të veçanta. Procedura administrative e natyralizimit mund të zgjasë deri në dy vjet.

Për informim:

- në komunën tuaj të banimit
- në Shërbimin e drejtësisë - sektori i natyralizimit (service de la justice – secteur des naturalisations)
- në Shërbimin e kohezionit multikulturor (service de la cohésion multiculturelle)

032 889 41 14

www.ne.ch/servicejustice

Rue de Tivoli 22, 2000 **Neuchâtel**

032 889 48 50

Rue des Beaux-Arts 13, 2000 **Neuchâtel**

www.ne.ch/cosm

Sa për dijeni

LEJET E QËNDRIMIT

Ju mund të merrni informata që kanë të bëjnë me lejet e qëndrimit pranë komunës tuaj të banimit ose pranë:

Shërbimit të emigracionit (Service des migrations)

Rue de Tivoli 28
2003 Neuchâtel

032 889 63 10
www.ne.ch/smig

Shërbimii i kohezionit multikulturor (Service de la cohésion multiculturelle), është në dispozicionin tuaj për çdo lloj informacioni lidhur me llojet e ndryshme të autorizimit për qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm.

SHKOLLAT

Të gjithë fëmijët pranohen në shkollat e detyrueshme të kantonit të Neuchâtelit.

Ju mund të merrni informata të nevojshme në administratën e komunës tuaj të banimit. Në moshën 4 vjeçare fillon arsimiti i detyrueshëm me një afat prej 11 vjetësh. Fëmija juaj mund të ndjekë gjithashtu kurse gjuhe dhe kulture të origjinës, të organizuara nga konsullatat ose bashkësitë përkatëse. Në përfundim të arsimit të detyruar, fëmija mund të vazhdojë studimet ose të ndjekë arsimin profesional.

Ju do t'i gjeni të gjitha hollësitë e nevojshme në adresën e mëposhtme:

Shërbimi i arsimit të detyruar (Service de l'enseignement obligatoire)

Rue de l'Écluse 67
2001 Neuchâtel

032 889 69 20
www.ne.ch/seo

Sa për dijeni

PLANI I KARRIERËS

Qendra e orientimit profesional, universitar dhe e karrierës (Centre d'orientation professionnelle, universitaire et de carrière) (OCOSP):

për nxënës, të rinj apo të rritur që dëshirojnë të ndërtojnë ose të rindërtojnë të ardhmen e tyre profesionale

032 889 20 20
www.ne.ch/ocosp

Zyrat regjionale nëshatelase të punësimit (Offices régionaux de placement neuchâtelais) (ORPN): për ata që janë në kërkim të një pune

032 889 68 13
www.ne.ch/orp

STUDIME DHE FORMACION PROFESIONAL

Shërbimi i formimit të pas-detyrueshëm dhe i orientimit (Service des formations post-obligatoires et de l'orientation) Espacité 1, 2300 La Chaux-de-Fonds

032 889 69 40
www.ne.ch/sfpo

Qendra ndërregjionale e formimit të Bjeshtëve të Neuchâtelit (Centre interrégional de formation des Montagnes neuchâtelaises) (CIFOM) Rue de la Serre 62, 2300 La Chaux-de-Fonds

032 886 30 00
www.cifom.ch

Qendra profesionale e Bregut të Neuchâtelit (Centre professionnel du Littoral neuchâtelais) (CPLN) Rue de la Maladière 84, 2000 Neuchâtel

032 717 40 00
www.cpln.ch

Qendra profesionale e mjeshtërive të ndërtimit (Centre professionnel des métiers du bâtiment) (CPMB) Les Longues-Raies 11, 2013 Colombier

032 843 48 00
www.cpmb.ch

Universiteti Av. du 1^{er} Mars 26, 2000 Neuchâtel

032 718 10 00
www.unine.ch

Zyra e bursave (Office des bourses) Espace de l'Europe 2, 2002 Neuchâtel

032 889 69 02
www.ne.ch/bourses



Sa për dijeni

FORMIMI TË RRITURVE

Aleanca e Qëndrave të Aftësimit Profesional e kantonit të Neuchâtelit
(Alliance des Centres de formation professionnelle du canton de Neuchâtel) (CEFNA)
Rue de La Serre 62 032 886 31 00
2300 La Chaux-de-Fonds www.cefna.ch

Shërbimi i punës (Service de l'emploi)
Rue du Parc 119 032 889 68 12
2301 La Chaux-de-Fonds www.ne.ch/semip

Qendra nëshatelase e integritimit profesional
(Centre neuchâtelois d'intégration professionnelle) (CNIP)
Site Dubied 12 032 889 69 25
2108 Couvet www.cnip.ch

Universiteti popullor i Neuchâtelit (Université populaire neuchâteloise) www.cpln.ch/upn
Rue de La Maladière 84
2000 Neuchâtel 032 725 50 40
Rue de La Serre 62
2300 La Chaux-de-Fonds 032 886 31 10

Shoqata të lexojmë e të shkruajmë (Association Lire et Ecrire) 032 914 10 81
Rue du Doubs 103, 2300 La Chaux-de-Fonds www.lire-et-ecrire.ch
Rue Louis-Favre 1, 2000 Neuchâtel

KURSE FRËNGJISHTEJE

Listën e kurseve të frëngjishtes, propozuar nga kantoni i Neuchâtelit mund ta gjeni **pranë Shërbimit të kohezionit multikulturor (Service de la cohésion multiculturelle)** në numrin e telefonit 032 889 74 42.





ne.ch

RÉPUBLIQUE ET CANTON DE NEUCHÂTEL

**SERVICE DE LA COHÉSION
MULTICULTURELLE**
AVENUE LÉOPOLD-ROBERT 90
2300 LA CHAUX-DE-FONDS
T +41 (0)32 889 74 42
F +41 (0)32 889 62 49

RUE DES BEAUX-ARTS 13
2000 NEUCHÂTEL
T +41 (0)32 889 48 50
F +41 (0)32 889 60 38

www.ne.ch/migrationsetintegration